



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:197925

Datë: 02.10.2024

Numri i dokumentit: 06244696

K.Dh.Sh.II.nr.300/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbarimore të “Klas Pek” D.O.O., me PIB:105023277, me seli në Merosina - Serbi, rruga “Cara Lazara”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokatura “Projusticia” në Prishtinë, kundër debitorit “Tava Group” Sh.p.k., me NUI:811365875, rruga “Dëshmorët e Kombit” nr.5, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Amir Bunjaku nga Prishtina, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1024/22 të datës 13.11.2023, me datë 30.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Klas Pek” D.O.O me seli në Gjilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1024/22 të datës 13.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1024/22 të datës 13.11.2023, në pikën I të dispozitivit Pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit “Tava Group” Sh.p.k., dhe i njëjti Urdhër Përmbarimor Anulohet

P.nr.664/21 të datës 03.06.2021 i Përmbauesit Privat Destan Bujupaj, dhe Përfundohet në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbaimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1024/22 të datës 13.11.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Klas Pek” D.O.O me datën 03.06.2021 ka paraqitur propozimin për përmbarim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, – Fatura nr.4/11 e datës 24.08.2020, ku e ka urdhëruar debitorin që brenda 7 ditëve pas pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit tërësisht borxhin sipas faturës në shumën prej 1,873.00 €, shumën e shpenzimeve të avokatit si dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.06/2014, nën kërcënimin e përmbaimit të dhunshëm. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbauesi privat të zbatoj përmbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se urdhri përmbaimit i atakuar është pasi që fatura nuk është nënshkruar nga ana e debitorit si dhe malli i përshkruar në faturë është i pa qarkullueshëm pasi që paketimet e produkteve kanë qenë të shqyera si dhe ka munguar specifikimi i vëllimit për produkt. Tutje ka shtuar se ka kërkuar nga kreditori që të kthehet malli dhe të zëvendësohet me tjetër sipas marrëveshjes të cilën nuk e ka përfillur kreditori. Në vazhdim ka deklaruar se për të metat e mallit kreditorin e ka njoftuar përmes telefonit dhe përmes postes elektronike, andaj i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj në tërësi prapësimin si të bazuar, shfuqizoj

urdhri përmbartimor si dhe të obligohet pala kreditore që ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore. Kreditori në përgjigjen në prapësim përmes të autorizuarit, ka theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, për arsye se kreditori e ka dorëzuar mallin siç ka qenë i përshkruar në faturë. Tutje ka shtuar se nuk është lajmëruar brenda afatit për të metat materiale brenda afatit ligjor sipas LMD-së. Fotot e bashkangjitura nuk dëshmojnë ditën e saktë kur janë vërejtur, andaj i ka propozuar Gjykatës ta hedh poshtë si të pa bazuar prapësimin si i pa bazuar si dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata ka vlerësuar se në rasti konkret konkret Fatura Nr. r.4/11 e datës 24.08.2020, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar shkalla e parë duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumentet, përkatësisht fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se Fatura nr.4/11 e datës 24.08.2020 edhe pse është pranuar nga debitori, të njëjtat janë kundërshtuar nga ana e debitorit përmes komunikimit të postes elektronike së datës 22.05.2021. Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së parë gjen se sipas shkresave të lëndës, pala kreditore propozimit të saj për përmbartim ia ka bashkangjitur faturën Nr. 4/11 e datës 24.08.2020, dhe e njëjta është kundërshtuar pas pranimit të saj, nënkupton se debitori të njëjtën nuk e ka pranuar dhe nuk është pajtuar me përmbajtjen e saj dhe për këtë arsye gjykata vlerëson

se faturat e pa nënshkruar dhe të kundërshtuara nga ana e debitorit, paraqesin dokumente të njëanshme dhe si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përmbardim.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbardim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbardimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbardimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranohet edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale Dhoma e shkallës së dytë, gjen se sipas shkresave të lëndës, pala kreditore propozimit të saj për përmbardim i'a ka bashkangjitur faturat Nr. 4/11 e datës 24.08.2020 në shumë prej 1.873.00euro, e cila nuk është e nënshkruar as pranuar nga debitori, në rastin konkret fatura nuk paraqet dokument të besueshëm. Andaj, Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin për përmbardim P.nr.664/21, të datës 03.06.2021, duke vlerësuar se fatura nuk i plotësojnë kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që të njëjtat nuk janë të pranuar dhe nënshkruara nga debitori. Sipas dispozitës së nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe*

debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, andaj në rastin konkret gjykata me të drejt ka vlerësuar se fatura në bazë të cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm sipas ligjit pasi që nuk është e pranuar nga debitori.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore, lidhur me at se fatura i është dërguar debitori më e-mail, mirpo nga shkresa elektronik nuk figuron se debitori ka konfirmuar pranimin e faturës, por gjen se debitori përmes komunikimit të postës elektronike të datës 22.05.2021 e ka kundërshtuar të njejtën, andaj një pretendim e till u refuzua si e pa bazuar, po ashtu kjo gjykatë i vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore por i refuzoj si të pa bazuar pasi që nuk kishin ndikim për vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.300/24, me datë 30.09.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri